

15 VJET

Universiteti Popullor Shqiptar
Raporti i Veprimtarisë për vitin 2011



Fjala e Kryesisë

Viti 2012 ishte, para së gjithash, viti i përvjetorit të themelimit të Universitetit Popullor Shqiptar (UPSH). Në 18 dhjetor ne festuam së bashku pesëmbëdhjetë vjetorin e kësaj qendre që afron e lidh njerëzit, që është e shumëfishtë në atë që ofron dhe e papërsëritshme në llojin e vet.

Kjo qendër formimi e hapur për të gjitha kombësitë, me kurse gjuhe, veprimtari të ndryshme dhe një shërbim ndihme për detyrat. Kjo qendër informimi e këshillimi shoqëror; dhe mbi të gjitha, kjo qendër shkëmbimi, takimesh e refleksionesh ndërmjet komuniteteve të ndryshme u krijon mundësinë artistëve me kulturë shqiptare të bëhen të njohur.

Përçues i fuqishëm integrimi, UPSH u shndërrua, në pesëmbëdhjetë vjet, në një vend referimi për njerëzit e gjuhës e të kulturës shqiptare ashtu si edhe për popullatën dhe institucionet e Gjenevës. Të falënderojmë sot këtu fuqishëm njerëzit dhe organizatat që i dhanë jetë e forcë UPSH-së gjatë gjithë këtyre viteve!

Pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme, duke filluar nga 2012, duken të pasura me sfida. Kohë të tjera, vende të tjera: përzierja multikulturore në rritje i hap UPSH-së horizonte të reja dhe e nxit për të gjetur - ku i dihet - një emër të ri dhe projekte të reja, më të gjera, më të hapura. Këto risi, duke përfshirë edhe të ardhmen e UPSH-së, do të vendosen nën një kryesi të re. E angazhuar profesionalisht gjithë javën në Bernë që sot e tutje, mua më duhet të heq dorë nga mandati im në UPSH. Por nuk do të jem edhe aq larg, sidomos jo me zemër.

Gjatë këtyre viteve të fundit, kam pasur shumë kënaqësi që kam punuar me të gjithë ju në shërbim të integritit. Kemi përpiluar projekte që nxisin shkëmbimin, dialogun dhe respektin reciprok midis njerëzve të emigruar dhe vendit të tyre të lindjes. Jemi munduar të kuptojmë dhe të konkretizojmë mundësinë që ky vend të bëhet në fakt më pritës, në këtë botën tonë njëherazi sa e hapur - ndaj fluksit të informacionit, ndaj lëvizjes së lirë - aq edhe e mbyllur - ndaj tjetrit, ndaj të tjerëve, ndaj ndryshimeve. Në mandatin tim politik, unë do të vazhdoj të angazhohem për ndërtimin e kësaj Zvicre të hapur.

Ashtu si dini të bëni ju, anëtarë të komitetit dhe të ekipit të UPSH-së, vazhdoni të angazhoheni me pasion, humanizëm e aftësi në shërbim të integritit! Bëni që t'ju falënderojnë gjithsecilin prej jush për punën që kryeni! Falë jush, komuniteti ynë nuk shpërbëhet: duke pranuar në gjirin e tij të gjithë anëtarët e anëtares më respektimin e integritetit të tyre, ai prish shtratin e fundamentalizmave dhe bëhet edhe më e fortë.

Për këtë, për gjithçka, një falënderim të madh!

*Maria Roth-Bernasconi,
Këshilltare kombëtare, Presidente e UPSH-së në 2011*





Universiteti Popullor Shqiptar

Komiteti i UPSH-së

Në 2011, shoqata numëronte mbi 300 anëtarë.

Përbërja e komitetit:

Maris Roth-Bernasconi, Presidente,
Besim Latifi, Nën-President,
Anahid Pashakhani, Thesarmbajtëse.
Kadri Avdullahi, Avni Isufi, Rajmonda Lila,
Gilbert Perrochon, Michel Riat, Martine Sumi,
Endri Gega.



Bashkëpunëtorë dhe bashkëpunëtorë të UPSH-së

Gjatë vitit 2011, UPSH-ja numëronte 29 vende pune, të zëna nga 42 bashkëpunëtorë e bashkëpunëtorë, 11 prej të cilëve rrogëtarë, 26 nëpunës me honorarë dhe 7 vullnetarë.

Vendet e rrogëtarëve:

- 1 vend koordinatorë (80%)
- 2 vende përgjegjës projekti (20% dhe 40%)
- 1 vend sekretare-receptioniste
- 1 vend asistenti koordinim projekti
- 1 vend shef llogarie (60%)
- 2 vende formatorësh të frëngjishtes - kurse intensive (50% -kontratë vjetore-subvencion i veçantë)
- 5 vende formatore të frëngjishtes - kurse për gra (pagë me orë - kontratë vjetore - subvencion i veçantë)



Ndërrim i lokaleve

Që nga fillimi i muajit shtator 2011, Universiteti Popullor Shqiptar ka zënë lokale të reja, në katin e parë të Chemin Surinam nr. a7.

Falënderime

Komiteti dhe ekipi i Universitetit Popullor Shqiptar falënderojnë përzemërsisht institucionet që kanë punuar dhe kanë marrë pjesë në realizimin si dhe në mbajtjen e veprimtarive e projekteve të propozuara gjatë vitit 2011.





Pesëmbëdhjetë vjet të UPSH-së 18 nëntor 2011

Pesëmbëdhjetë...

vjet angazhimi, pritjeje, takimesh
e këmbimesh;

formimi e informimi, nxitjeje për integrim;
një përkrahje e çmuar e personaliteteve
publike;

një mbështetje pa rezervë e institucioneve
të këtushme dhe të atyre të Ballkanit.



«... Të angazhuar në një garë të imponuar nga një ksenofobi e egër shqiptarët po aq sa zviceranët, kanë ende një distancë shumë të madhe për të përshkuar. Nga kjo garë varet jo vetëm integrimi i nevojshëm i komunitetit të dytë të huaj në Zvicër, por edhe bashkëjetesa e përhershme e komuniteteve të ndryshme në këtë vend...»

Ueli Leuenberger, themelues i UPSH-së

«... Përçues i fuqishëm integrimi, UPSH u shndërrua, në pesëmbëdhjetë vjet, në një vend referimi për njerëzit e gjuhës e të kulturës shqiptare ashtu si edhe për popullatën dhe institucionet e Gjenevës. Të falënderojmë sot këtu fuqishëm njerëzit dhe organizatat që i dhanë jetë e forcë UPSH-së gjatë gjithë këtyre viteve!»

Maria Roth-Bernasconi, presidente e UPSH-së

«... A më duhet të theksoj se deri ne ç'pikë UPSH-ja përmbush sot një detyrë më se të nevojshme? Përfshirja e saj në mësimin e gjuhës frënge ashtu si dhe njohja e promovimi i kulturës shqipfolëse janë më shumë se kurrë themelore. UPSH-ja është një institucion fisnik, i cili që nga themelimi i tij, e kuptoi se integrimi i të huajve nuk mund të bëhej nëpërmjet një asimilimi të thjeshtë të kulturës së vendit pritës...»

Thierry Apothéloz, Kryetar i Bashkisë Vernier



Cikli i tryezave të rrumbullakëta

Mars-Dhjetor 2011.

**«Integrimi i shqipfolësve në Zvicër:
Si janë ndjekur masat?»**

Organizimi:

Universiteti Popullor Shqiptar & Albinfo;

Objektivat:

Të bëhen të njohura, në këndvështrime të ndryshme, popullatat shqiptare në Zvicër dhe realitetet e emigracionit që kanë të bëjnë me ta;

Të nxirren në pah marrëdhëniet midis shoqërisë pritëse dhe emigrantëve;

Trajtimi i funksionimit të shoqërisë zvicerane në kuptim të gjerë si dhe se çfarë pret ajo për sa u përket emigrantëve;

Përcaktimi i problematikave që prekin emigracionin shqiptar me qëllim nxitjen e debateve dhe gjetjen e perspektivave të mundshme.



Përfaqësimi shoqëror i të huajve në Zvicër

Dita kundër racizmit

20 mars 2011 - Salla e Môle, Gjenevë

**Diskriminimi dhe vetëdiskriminimi
i shqiptarëve në Zvicër**

31 maj 2011 - Le Cazard, Lozanë



Kosova: midis dialogut dhe tensioneve

27 shtator 2011 - Universiteti i Bernës

**Pjesëmarrja e emigrantëve
në jetën politike të Zvicrës.**

7 tetor 2011 - Universiteti Popullor Shqiptar, Gjenevë



Roli i gruas shqiptare në Zvicër:

**Evoluimi i statusit familjardhe integrimi
shoqëror e profesional**

16 nëntor 2011 - Shtëpia e Shoqatave, Gjenevë

roli i diasporës në zhvillimin

e vendeve të Ballkanit perendimor

6 dhjetor 2011 - Universiteti Popullor Shqiptar, Gjenevë



Emisione televizive «In&Out»

Të transmetuara nga Televizioni Publik i Kosovës

Organizimi:

Universiteti Popullor Shqiptar & Albinfo;

Kanalet e parashikuara për promovim:

- Gazeta e UPSH-së
- Publiku pjesëmarrës në tryezat e rrumbullakëta
- Faqja e Internetit albinfo.ch
- Newsletter albinfo.ch
- Facebook
- Televizioni kombëtar i Kosovës

Popullatat që synohen:

- Popullata dhe institucione të Gjenevës e të Zvicrës (komunat, kantonet dhe Konfederata);
- Brezi i dytë i emigrantëve ballkanas, nëse dëshirojnë të kuptojnë më mirë përparësitë e njohjes së gjuhës amtare.
- Emisionet janë në dispozicion të përhershëm për publikun në platformën albinfo.ch. 2'000 deri 3'000 përdorues interneti vizitojnë çdo ditë këtë faqe interneti trigjuhëshe (shqip, frëngjisht e gjermanisht), një pjesë jo e vogël e të cilëve janë frëngjishtfolës.



Intervistë me Zonjë Micheline Calmy Rey, Presidente e Konfederatës (11 nëntor 2011)

«Kultura e kulturave»

«Pushimet po afrohen»

«Djalë apo vajzë»

«Përvojat e kthimit në atdhe»

«Diaspora në metamorfozë»

«Shëndeti këtu, shëndeti atje»




«Të rritesh shqip»

«Të jesh secundos shqiptar»

«Potencialet tona»

«Feja në diasporë»

«CH-Kosovë: Ku mbetën pensionet tona?»



Kurse frëngjishteje

Në 2011, UPSH-ja propozoi kurset e mëposhtme:

- Kurse të rregullta të gjuhës frënge për nivelin fillestar dhe për nivelin ndërmjetës, të përziera dhe të veçanta për gra (2 x 2 orë në javë);
- Kurse intensive të gjuhës frënge për nivelin fillestar dhe për nivelin ndërmjetës, të përziera dhe të veçanta për gra (4 x 2 orë në javë);
- Atelier bisedash dhe shkrimi (për vitin shkollor 2011-2012).

Kurset zhvillohen në lokalet e UPSH-së dhe në lokalet e shoqatave partnere të projekteve të veçanta: Shtëpia e Lagjes së Akacieve, Shtëpia e Lagjes së Pilivesave në Vernier dhe lokali La Pelotière në Versoix. Dëshirojmë të falënderojmë ngrohtësisht partnerët tanë në sajë të të cilëve realizuam zhvillimin e këtyre kurseve që janë: Zyra e Integritit të të huajve, Qyteti i Vernier, Shtëpia e Lagjes së Akacieve, Shkolla e Pilivesës, Rrjeti i arsimit përparësor, Shërbimi mediko-pedagogjik, Shoqata për gjallërimin e Akacieve dhe Shtëpia e lagjes së Akacieve, qytetin e Versoix dhe FASE.

Gjatë vitit 2011, 470 vetë, midis moshës 18 dhe 63 vjeç, me preardhje të ndryshme, kanë ndjekur kurset e UPSH-së. 207 vetë kanë ndjekur kurset intensive dhe 94 gra kanë përfutur kurse të veçanta. Sasia e pjesëmarrjes është mbi 85%.

Pjesëmarrja:

- Kurse intensive të përziera: 171 vetë
- Kurse të rregullta të përziera: 204 vetë
- Kurse intensive të veçanta «gra»: 37 vetë
- Kurse të rregullta të veçanta «gra»: 57 vetë

Vendet e origjinës të kursantëve:

Afganistani, Shqipëria, Gjermania, Algjeria, Argjentina, Armenia, Bangladeshi, Bolivia, Bosnja, Brazili, Bullgaria, Kanadaja, Kina, Kolumbia, Danimarka, Egjipti, Emiratet e Bashkuara Arabe, Ekuatori, Eritrea, Spanja, Shtetet e Bashkuara, Etiopia, Gana, Gjeorgjia, Guine Bissao, Hondurasi, Hungaria, Hong-Kongu, India, Irani, Iraku, Italia, Jordania, Kenia, Koreja, Kosova, Libani, Maqedonia, Maroku, Meksika, Moldavia, Mongolia, Nepali, Nigeria, Uganda, Uzbekistani, Pakistani, Panamaja, Paraguai, Peruja, Filipinet, Portugalia, Republika Dominikane, Rumania, Rusia, Ruanda, Salvadori, Senegali, Serbia, Somalia, Sudani, Sri-Lanka, Zvicra, Siria, Tajvani, Tanzania, Tailanda, Turqia, Ukraina, Jemeni...



Dalje kolektive

Kurse frëngjishteje të UPSH-së

Momente të ndryshme të vitit dhe vende të ndryshme të Gjenevës

Gjatë vitit shkollor kursantët e mësimëve të ndryshme të frëngjishtes, marrin pjesë rregullisht në dalje kolektive, gjatë të cilave grupet takohen dhe kanë mundësinë të njihen më mirë midis tyre.



Seancë informimi për depistimin e kancerit të gjirit

Kurs i veçantë «gra» i Libellules

Seancë e propozuar nga Fondacioni i Gjenevës për depistimin e kancerit të gjirit

20 maj 2011, Shtëpia e Lagjes së Libeluleve

Gjatë kësaj seance, ligjërues të jashtëm informuan kursantet mbi mundësitë e depistimit dhe folën për programin e parandalimit të hartuar nga kantoni i Gjenevës. Biseda u pasua nga një diskutim.



Drekë kanadeze me rastin e fundit të vitit 2011.

Kurs i veçantë «gra» i Libelulave

11 nëntor 2011, Shtëpia e Lagjes së Libelulave

Fundi i vitit 2011 u festua përreth një tryeze me specialitete të kuzhinës kanadeze, në shoqërinë e bashkëpunëtorëve të Shtëpisë të Lagjes së Libeluleve.



Dalje e fundit të vitit 2011

Kurs i veçantë «gra» e Versoix

11 nëntor 2011, Qebap i Cornavin

Për të festuar fundin e vitit 2011, kursantet e kursit të Versoix, kaluan së bashku një drekë në Qebap të Cornavin, të zgjedhur nën kujdesin e tyre.



Festa e Ngjitjes (Escalade)

8 dhjetor 2011, Universiteti Popullor Shqiptar.

Përvjetori i fitores së Gjenevës u festua denjësisht duke parë një film mbi temën e ngjitjes (Escalade) dhe duke thyer tenxheren e bonboneve në familje, sipas traditës.



La Marelle

Qendër pritjeje prindër-fëmijë

Gjatë vitit 2011 La Marelle ka pritur fëmijë të moshës parashkollore dhe prindërit e tyre në gjirin e hapësirës së pritjes së UPSH-së, ashtu si dhe në kuadrin e kurseve të veçanta të gjuhës frënge për gra të propozuara në lokalet e Shtëpisë së Lagjes së Akacieve.



La Marelle numëroi në lokalet e saj mbi 450 prani të fëmijëve dhe afër 250 prani prindërisht, të hënën, të martën, të enjten e të premten, midis orës 9 e 14 (deri në muajin qershor) dhe midis orës 9 e 16 (duke filluar nga shtatori).



Midis janarit dhe qershorit 2011, gjatë veprimtarive të propozuara në kuadrin e «la Marelle aux Accacias», La Marelle numëroi afër 90 prani fëmijësh dhe mbi 200 prani të rriturish.



Në kuadrin e pritjes në UPSH, një atelier kuzhine u propozua një herë në muaj, midis janarit dhe qershorit. Atelier të shprehjes krijuese e të punëve të dorës u propozuan nga La Marelle gjatë veprimtarive të ndryshme të organizuara nga UPSH (Festa kundër racizmit; Pesëmbëdhjetëvjetori i UPSH; Festa e Ngjijtjes (Escalade); Festa e fundit të vitit).



Personeli i ngarkuar me La Marelle përbëhet nga katër bashkëpunëtore vullnetare dhe një përgjegjëse projekti.

Në 27 janar u zhvillua në Lozanë një takim midis përgjegjësit të ODM, qendrës së vlerësimit të projektit «Nxitja e integritit në lëmin parashkollor» dhe shoqatat e instancat që kanë marrë pjesë në projekt dhe përfitojnë financimin e ODM-së.

Në 14 prill, La Marelle u vizitua nga përgjegjësi i ODM-së në kuadrin e «Nxitjes së integritit në lëmin parashkollor».

Në 22 shtator u zhvillua në Bernë dita e njoftimit të rezultateve të para të vlerësimit të projekteve ODM.

Një kalendar 2012 u realizua dhe iu shpërnda falas partnerëve tanë.



Dita kundër racizmit

20 mars 2011

Salla e Môle, Gjenevë

- Fjala e mirëseardhjes e presidentes së UPSH, Maria Roth-Bernasconi
- Muzikë tradicionale shqiptare nga grupet amatore në Gjenevë
- Tryezë e rrumbullakët
- Moment muzikor
- Fjalimi i Zonjës Sandrine Salerno, kryetare e bashkisë së qytetit të Gjenevës
- Lexim publik nga tre breza grash artiste: nëna, Elsa Myftiu dhe e bija, shkrimtarja Besa Myftiu, të shoqëruara në muzikë nga mbesa, Elina Duni
- Valle shqiptare
- Pjesë teatrale:
«E parë nga ura» e Artur Milerit nga teatri Kurora
Përshtatur dhe vënë në skenë nga Visar Qusaj.
Aktorë: Julien Pasquier, Karine Mazza, Alison Jaccard, Arben Krasniqi, Agon Rexhaj, Gent Rexhaj
- Stenda të shoqatave shqiptare në Gjenevë
- Veprimtari për fëmijë (klounë, vizatim, qindi, makijazh) të organizuara gjatë gjithë ditës në hapësirën prindër-fëmijë të UPSH, La Marelle



Kurse të gjuhës shqipe

Prej shumë vitesh, një sesion vjetor kurseesh të gjuhës shqipe u propozohet atyre që dëshirojnë të mësojnë bazat e gjuhës shqipe.

Libër recetash: «Receta të të gjitha vendeve»


Kjo përmbledhje është shtypur në përfundim të atelieve të kuzhinës të organizuara në kuadrin e kurseve intensive të mësimi të frëngjishtes, kurse për gra, të mbajtura në lokalet e Shtëpisë së Lagjes së Libellulave në 2011. Këto atelie kanë shërbyer si pretekst për të komunikuar dhe shpjeguar, për t'u informuar dhe riformuluar në një kuadër më pak zyrtar, duke favorizuar të shprehurit e lirshëm, spontan. Nëpërmjet shkëmbimit, krahasimit të traditave të ndryshme kulinare, synohet njohja dhe hapja ndaj multikulturalizmit.



Takim ndërkulturor i të rinjve

13 nëntor 2011, Gjenevë

Ky takim ishte rast i mirë për të treguar hapjen dhe dëshirën për dialog të komunitetit shqiptar ndaj besimeve të të tjerëve. Për të krijuar një klimë të përshatshme për dialog dhe për ta bërë të dukshme këtë hapje, UPSH i bëri thirrje Qendrës Kulturore Islamike të Gjenevës. Një grup prej pesëmbëdhjetë praktikan-tësh, me imamin e xhamisë alabandine në krye, erdhi në lokalet e Kishës Katolike Romane dhe mori pjesë në debatet e organizuara.



Mbas fjalës së hapjes, të mbajtur nga koordinato- rja, Zonja Krasniqi, dhe një ekspozë shoqërore-politike të Z. Izeni, myslimanë e katolikë morën pjesë në një diskutim plot pasion, i karakterizuar nga respekti dhe shkëmbimi i ndërsjellët. Falënderojmë Kishën Katolike dhe veçanërisht Zotin Schmidt për pritjen e rezervuar.



Programi i takimit:

- Atelie
- Dëshmi dhe këmbime në grupe
- Meshë ndërkulturore
- Drekë e përgatitur nga komunitetet
- Shfaqje





Veprimtari kulturore dhe letrare

- Festa e pavarësisë së Kosovës
17 shkurt 2011
- Festa e Flamurit
28 nëntor 2011
- Tre promovime librash
- Një pjesë teatrale



Raporti i OCDE

Koordinatorja u ftua në seancën e OCDE, në kuadrin e delegacionit të CFM në të cilin ajo bën pjesë, për të raportuar mbi gjendjen e myslimanëve shqiptarë në Zvicër.

OCDE-ja paraqiti një raport përfundimtar, të cilin mund ta gjeni në faqen e Internetit të CFM.




Procesi i Bernës, Kuvendi i Përgjithshëm i shqiptarëve të Zvicrës

UPSH është anëtar i Këshillit Strategjik që nga maji 2011 dhe merr pjesë në takimet e grupit të ekspertëve disa herë në vit me qëllim realizimin e ndjekjes së punës së Kuvendit të Përgjithshëm.



Pjesëmarrja në rrjete dhe bashkëpunime ndërmjet shoqatave

G9, Camarada, AGAS, OSAR, UOG, KULTURA, StioExclusion, LEPA, Tierra Cognita, FASE, UPG, FC Kosova, Rinia Contact, Albinfo, ISEAL, CCSI, OSEO, REP, etj.





Après-Ge

Universiteti Popullor Shqiptar është anëtar i Dhomës Ekonomike Shoqërore dhe Solidare, APRES-GE (www.apres-ge.ch) dhe merr pjesë, në këtë cilësi, në promovimin e ekonomisë shoqërore dhe solidare, vlerave të saj dhe të projektit të saj shoqëror. Si strukturë ekonomike e shoqërore, ne e gjejmë veten në parimet dhe vlerat e Kartës së ESS së Gjenevës:

- Mirëqenie shoqërore: të jesh, më shumë se sa të kesh
- Qytetari dhe demokraci pjesëmarrëse: zëri i gjithsecilit është i rëndësishëm
- Ekologji: të prodhojmë për të jetuar dhe jo të jetojmë për të prodhuar
- Autonomie: autonomë por jo individualistë
- Solidaritet: 1+1>2
- Larmii: të pasur në ndryshimet tona
- Koherencë: ta thuash atë që bën dhe ta bësh atë që thua

Seanca informimi

17 seanca formimi informimi dhe sensibilizimi

- Shkolla e Policisë e Gjenevës
- Azili i Përgjithshëm
- Shkolla të Gjenevës
- Formimi profesional BEJUNE/Bienne
- Shkolla e Policisë/Savatan
- Kurse formimi mbi ndërkulturalizmin në Gjenevë, Neuchâtel, Delémont
- Infermieret shkollore/Gjenevë

Publiku i prekur: rreth 370 vetë me origjinë të ndryshme. Bashkëpunëtorë: OSAR, Azili i Përgjithshëm, Shkolla, Komuna.

Takimet FDEP

3 nëntor 2011, Yverdon

Ekipi pedagogjik i UPSH-së mori pjesë në Takimet 2011 të organizuara nga FDEP, mbi temën «Vetëformimi i formatorëve të të rriturve: çfarë praktikash pedagogjike?».

journalgazeta

Shërbim shoqëror Shërbim juridik

39 kërkesa për konsultim,
shoqërim, këshillim, informim



Gazeta e UPSH

Gazetë falas
4 dalje në 2011

Temat e trajtuara:

- Veprimtari, dhe festa të UPSH
- Programet e kurseve
- Aktualitetet kulturore dhe letrare
- Programe dhe përmbledhje të tryezave të rrumbullakëta
- Paraqitje të veprimtarive të partnereve
- Paraqitje të personaliteteve aktive në gjirin e shoqatës ose në lidhje me objektivat e saj
- Mbështetje për çështjet që kanë lidhje me qëllimet dhe objektivat e shoqatës
- Receta kuzhine të përpiluara në kuadrin e kurseve të veçanta të organizuara për gratë
- Kalendarit 2012 i realizuar në kuadrin e qendrës së fëmijëve La Marelle
- Urimet për Vitin e Ri
- Etj.





1996
2011

Université Populaire Albanaise

Chemin Surinam 7 • 1203 Genève
tél: 022 340 25 77 • fax: 022 340 25 79
e-mail: upa-upsh@upa.ch • internet: www.upa.ch